



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT

Tiranë, më 17.02. 2025

Lënda: Njoftim për shpallje konkursi për 2 (dy) vende pune për personel administrativ, me kohë të plotë në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

**DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE**

**K Ë T U**

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, gërma f, neni 67, pika 3, në Statutin e UST-së, kreu V, neni 50, në Rregulloren e UST-së, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, në VKM nr. 305, datë 05.04.2017 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” të ndryshuar, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 67, datë 29.09.2023 “Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë”, në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 58, datë 21.12.2020 “Mbi miratimin e kriterëve për hapjen e procedurave të konkursit për punonjës pastrimi /sanitar në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse”, si dhe në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.08, datë 29.01.2025 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimin e pagës për vitin 2025”, shpall kriteret për 2 (dy) vende pune për personel administrativ, me kohë të plotë në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si më poshtë;

- 1 (një) “**Drejtor**”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.
- 1(një) “**Punonjës Pastrimi/Sanitar**”, në Sektorin e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

I. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për “**Drejtor**” në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, janë si më poshtë:

**Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

## **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:**

1. Arsimimi: Kandidati që konkuron në pozicionin e punës duhet të zotërojë së paku diplomë të nivelit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të në fushën e drejtësisë ose ekonomikut.
2. Përvoja: Të ketë përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet në profesion.
3. Tjetër: Njohuri të legjislacionit dhe procedurave të tjera administrative e juridike, njohuri në prokurimet publike.

## **Vlerësimi i Intervistës.**

1. Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.
2. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
  - a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
  - b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
  - c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

## **II. Kandidatët që do të aplikojnë për vendin e punës si “Drejtor”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse duhet të dorëzojnë këto dokumenta:**

1. Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me standartet e legjislacionit shqiptar.
2. Diplomë e shkollës së lartë dhe certifikatë notash e noterizuar.
  - Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njohuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
  - Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
3. Vërtetim i pagesës së kontributeve nga e-albania për të vërtetuar vjetërsinë në punë.
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
5. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore.
6. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore ose dëshmi penaliteti lëshuar nga e-albania.
7. Referenca të ngjashme të punës.
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë.

## **III. Kriteret për hapjen e procedurave të konkursit për 1 (një) pozicion pune si “Punonjës Pastrimi/Sanitar” në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse janë si më poshtë:**

1. Të ketë mbaruar arsimin e ulët tetë (8) ose nëntë (9)-vjeçar ose arsimin e mesëm.
2. Të ketë eksperiencë pune në këtë pozicion përbën avantazh.
3. Të ketë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.
4. Intervista.

## **Kandidatët që do të aplikojnë për vendin e punës si “Punonjës pastrimi /sanitar” duhet të dorëzojnë këto dokumenta:**

- a. Kërkesë për vendin e punës.
- b. CV
- c. Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme ose certifikatë notash për arsimin e ulët tetë (8) ose nëntë (9)-vjeçar.

- d. Dëshmi penaliteti
- e. Certifikatë e gjëndjes familjare.
- f. Raport mjeko ligjor, që vërteton aftësinë për punë.

#### **IV. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit**

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

#### **V . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët**

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Drejtoria, emri, mbiemri, adresa e konkurentit.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.
- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për datën e zhvillimit të intervistës.

### **DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT**